


JU-81-07-176-SQ-C

Komisioni Evropian, Drejtorati Gjeneral për Zgjerim,
Njësia për informim dhe komunikim A2
Adresa: Rue de la Loi 200, B-1049 Bruksel
Tel: (+32 2) 295 36 79, Fax: (+32 2) 299 17 77



ISBN 978-92-79-11333-8



9 789279 113338

IPA

Instrumenti për asistencë të
Para -
Anëtarësimit

**Fokusi i ri i Asistencës së
BE-së për zgjerim**

Komisioni
Evropian





IPA

Instrumenti për asistencë të
Para -
Anëtarësimi

**Fokusi i ri i Asistencës së
BE-së për zgjerim**

As Komisioni Evropian, as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit nuk është përgjegjës për shfrytëzimin që do të mund të bëhej nga informacioni në vijim.

Evropa Direkt është një shërbim i cili ju ndihmon t'i gjeni përgjigjet në pyetjet tuaja mbi Bashkimin Evropian

Telefoni pa pagesë (*):
00800 6 7 8 9 10 11

(*) Disa operatorë të telefonisë mobile nuk e mundësojnë qasjen në numrat 00800 ose këto thirrje mund të jenë me pagesë

Një pjesë e konsiderueshme e informacionit shtesë mbi Bashkimin Evropian ndodhet në Internet. Ai mund të arrihet përmes serverit Europa (<http://europa.eu/>).

Të dhënat e katalogimit mund të gjenden në fund të këtij publikimi (<http://europa.eu.int/comm/enlargement/>).

ISBN-13 978-92-79-11333-8

Komisioni Evropian, Drejtorati Gjeneral për Zgjerim, 2008 © Komunitetet Evropiane 2008
Riprodhimi është i autorizuar nëse tregohet burimi.

E shtypur në Kosovë*

*nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB

Hyrje	4
Çka është IPA?	5
Çfarë bën IPA?	6
Pse është krijuar IPA?	7
Si funksionon IPA?	8
Kroacia	9
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	10
Turqia	11
Shqipëria	12
Bosnja dhe Hercegovina	13
Kosova	14
Mali i Zi	15
Serbia	16
Mbështetja për shumë vende	17
Përparësitë e IPA-së	18
Informata shtesë mbi IPA-n	19

Zgjerimi i Bashkimit Evropian ka qenë gjithmonë proces dy-drejtimesh. Shtetet anëtare të reja përfitojnë nga fakti i përkatësisë në këtë organizatë unike-bloku më i madh tregtar i botës dhe ushtrimi më i avancuar në qeverisjen e përbashkët. BE fiton duke u zgjeruar në territore më të gjëra, duke mirëpritur kultura të reja, dhe duke u lidhur me tregje të reja.

Përgjatë viteve të fundit, ky proces dy-drejtimesh ka marrë një dimension shtesë pasi që BE ka filluar të integrojë vende nga bota e ndryshimeve rapide në kufijtë e saj lindorë. Shumë shtete kandidatë është dashur të ndërmarrin reforma rrënjësore- ekonomike, politike dhe sociale – për tu kualifikuar për anëtarësim në BE.

Reformat sjellin përfitime në vend, por shpesh kërkojnë investime të kush-tueshme dhe paraqesin sfida afat-shkur-ta për vendet në rrugën e tyre drejt

anëtarësimi. Si përgjigje, BE ka ofruar shumë forma të ndryshme të asistencës- në para dhe ekspertizë- për vendet që i marrin detyrat e anëtarësimi.

Që nga 2007, e gjithë asistencë e BE-së për vendet me perspektivë për anëtarësim në BE- Turqia dhe Ballkani Perëndimor- është sjellë nën një titull, Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimi (IPA). Kjo ka sjellë një fokus të ri të BE-së për asistencë zgjerimit.

Kjo broshurë ofron një pasqyrë për atë se çka është IPA, pse është krijuar, si funksionon, dhe si përfiton nga ajo BE-ja dhe vendet që kërkojnë t'i bashkëngjiten.

"Thelbi i çështjes në procesin e zgjerimit të BE-së është në reformat politike, ekonomike dhe institucionale që qojnë në rezultatet në terren, në secilin vend. Ata duhet të reagojnë në këtë proces sfidues. Por ata nuk janë vetëm. BE qëndron në anën e tyre me mbështetje politike, këshilla teknike dhe asistencë të konsiderueshme financiare për t'iu ndihmuar atyre t'i ndërmarrin këto reforma"

Komisioneri për Zgjerim Olli Rehn, qershor 2007, në finalizimin e planifikimit strategjik të asistencës së IPA-s

IPA – Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimi- është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE për të ofruar ndihmë në mënyrë efikase Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Nevojat dallojnë në mes të vendeve kandidatë – Turqisë, Kroacisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë – si dhe kandidatëve potencialë – Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë. IPA është dizajnuar që t'i plotësojë në mënyrë precize këto nevoja me një instrument të vetëm por fleksibil.

Është shenjëstruar që të përfitojnë qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë. Projektet që i mbështetë janë të përgatitur në atë mënyrë që vendet kandidatë dhe ato kandidatë potenciale t'i afrojnë në linjë me standardet e BE-së.

IPA ka hyrë në fuqi në fillim të 2007, dhe do të ofrojë afërsisht €11.5 miliardë për këto vende për vitet 2007-2013. Alokimi për secilin vend për periudhën 2007-2012, është si në vijim:

Asistencë financiare e BE-së nën IPA për 2007-2012, në € milionë

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2007-2012
Kroacia	141.2	146.0	151.2	154.2	157.2	160.4	910.2
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	58.5	70.2	81.8	92.3	98.7	105.8	507.3
Turqia	497.2	538.7	566.4	653.7	781.9	899.5	3.937.4
Shqipëria	61.0	70.7	81.2	93.2	95.0	96.9	498.0
Bosnja dhe Hercegovina	62.1	74.8	89.1	106.0	108.1	110.2	550.3
Kosova	68.3	184.7	106.1	67.3	68.7	70.0	565.1
Mali i Zi	31.4	32.6	33.3	34.0	34.7	35.4	201.4
Serbia	189.7	190.9	194.8	198.7	202.7	206.8	1.183.6
Mbështetja për shumë vende	109.0	135.7	160.0	157.7	160.8	164.2	887.4
TOTALI	1.218.4	1.444.3	1.463.9	1.557.1	1.707.8	1.849.2	9.240.7

Statusi: Nëntor 2008

◇◇◇

1 Nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

◇◇◇

2 Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1085/2006 të 17 korrik 2006 mbi themelimin e një Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimi

IPA ofron asistencë në forma të ndryshme për vendet që ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE:

- ◇ investime, kontrata prokurimi apo subvencione;
- ◇ Ekspertë të Shteteve Anëtare për të ndërtuar bashkëpunim administrativ;
- ◇ veprime në mbështetje të vendit përfitues;
- ◇ ndihmë në implementimin dhe menaxhimin e programeve;
- ◇ në raste të jashtëzakonshme, mbështetje buxhetore.

Asistenca lidhet me përmirësimin e kushteve në vendet përfituese dhe afrimi i tyre dhe qytetarëve të tyre me BE-në.

Në qershor 2007, Komisioni Evropian ka finalizuar planin e parë strategjik të asistencës nën IPA për vitet 2007-2009. Ky ishte i bazuar në nevojat specifike të secilit vend, dhe i ka renditur prioritetet për asistencën financiare. Programi për shumë vende poashtu mbështetë projektet e përbashkëta rajonale të bashkëpunimit, in-

frastrukturës, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, tregut të brendshëm dhe tregtisë, ekonomisë së tregut, mbështetjes së shoqërisë civile, arsimimit, rinisë dhe hulumtimit. Planifikimi strategjik freskohet çdo vit.

“Asistenca e ofruar do të përdoret në fushat në vijim: forcimi i institucioneve demokratike, sikur edhe sundimit të ligjit, përfshirë forcimin e tij; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe respektin e rritur për të drejtat e pakicave, promovimin e barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit; reformën e administratës publike; reformën ekonomike; zhvillimin e shoqërisë civile; përfshirjen sociale; pajtimin, masat për ndërtimin e besimit dhe rindërtimin; bashkëpunimin rajonal dhe ndër-kufitar.”

- Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, Bruksel, 17 korrik 2006

BE mbështetë projekte për sigurinë e transportit detar në Turqi. Punëtorët përballen me rreziqe të sigurisë me nivel të lartë të lëndimeve aksidentale në vendin e punës. Në maj 2008 është lansuar një projekt 18-muajsh për të përmirësuar kapacitetin inspektues për shëndetësi dhe siguri të autoriteteve turke, financuar me €1.3 milion nga IPA.



IPA është dizajnuar për të maksimizuar fokusin, precizitetin dhe ndikimin në përmbushjen e nevojave të para-anëtarësimit nëpërmes një kornize të vetme të thjeshtëzuar.

IPA sjellë një shkallë të pajtueshmërisë dhe konsistencës në veprimin e Bashkimit, duke arritur rezultate edhe më të mira me burimet në dispozicion.

IPA zëvendëson pesë instrumentet e mëhershme të para-anëtarësimit të BE-së - Phare, ISPA, SAPARD, programin e Turqisë, dhe CARDS.

IPA do t'i ndihmojë vendeve kandidatet që të implementojnë në tërësi legjislacionin e BE-së ("Community acquis") në kohën që ata bëhen Shtete Anëtare. Vendet kandidatet potenciale ndihmohen që të

përafrojnë legjislacionin e tyre në mënyrë progresive me legjislacionin e BE-së.

Instrumenti i ri është poashtu i përcaktuar që në mënyrë progresive t'iu besojë administratave të vendeve përfituese menaxhimin e fondeve të BE-së.

Përveç rritjes së ndenjes së pronësisë në projektet e para-anëtarësimit, kjo poashtu do u ndihmojë vendeve që të përgatiten për metodat e menaxhimit që ata do t'i përdorin pasi që të vijnë në pozitë që të përfitojnë nga fondet si Shtete Anëtare të BE-së.

IPA fokusohet në nevoja. Kështu që prioritetet e saj janë të bazuara në vlerësimet të qarta. Elemente kryesore janë Partneritetet Evropiane/të anëtarësimit që BE i ka lidhur me çdo vend përfitues, dokumenti strategjik i Komisionit për zgjerim, dhe raportet vjetore për secilin shtet.

Kriteri i shpërndarjes merr parasysh kapacitetin e çdo vendi për të përdorur dhe menaxhuar me fondet, dhe respektimin e kushteve të anëtarësimit. Dispozita e suspendimit mund të aplikohet nëse nuk janë përbushur kushtet. Në këtë mënyrë, IPA ofron një lidhje në mes të kornizës politike për zgjerim dhe procesit të buxhetimit të BE-së.

IPA përmban pesë komponente. Dy prej tyre- ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimi ndër-kufitar – janë në disponim të të gjitha vendeve përfituese. Tri komponentet tjera – zhvillimi rajonal, zhvillimi i burimeve njerëzore, dhe zhvillimi rural- i janë vënë në disponim vetëm vendeve kandidatë. Pasi që këto tri grupe të IPA-s në veçanti bëjnë përgatitjen për menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së dhe mbësh-

tetjen bujqësore, ato kërkojnë kapacitete dhe struktura administrative të zhvilluara.

Fondet shpërndahen në linjë me kornizën financiare tre-vjeçare indikative të lidhur me kornizën politike të zgjerimit. Kjo ofron informacione mbi qëllimet e Komisionit për vendet dhe komponentet.

Mbi këtë bazë, dokumentet shumë-vjeçare indikative të planifikimit pastaj përgatiten për çdo vend (plus një për programin për shumë vende). Këto dokumente përmbajnë objektivat specifike të Komisionit dhe zgjedhjet e ndihmës së para-anëtarësimit, të cilat rivedohen dhe azhurnohen për çdo vit.

Kush mund të merr pjesë?

Pjesëmarrja në dhënien e kontratës apo grantit është e hapur për të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare, personat juridikë të themeluar në Shtetet Anëtare të BE-së apo Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), vendi që është përfitues i IPA-s apo Instrumentit të Partneritetit Evropian të Fqinjësisë, dhe organizatave ndërkombëtare.

IPA poashtu vepron si katalizator për të joshur më shumë investime vendore dhe të huaja, përfshirë edhe shumën financiare për zhvillim të Bankës Evropiane të Investimeve prej €25 milionë për ndërmarrjet e vogla dhe amvisëritë private për kreditë rurale dhe të banimit në Evropën Jug-Lindore. *“Këto aktivitete janë plotësisht në linjë me Instrumentin për e BE-së për Asistencë të Para-Anëtarësimit e fokusuar në joshjen e investitorëve privatë në këtë rajon.”*
Banka Evropiane e Investimeve, nëntor 2007.



Për Kroacinë, strategjia për asistencën e para-anëtarësimit është e koncentruar në ndërtimin e institucioneve, bashkëpunimin ndër-kufitar dhe përgatitjen për implementimin e politikës së përbashkët bujqësore të BE-së dhe politikës kohezeve.

Në dhjetor 2007 Komisioni Evropian miratoi investimin prej €180.7 milionëve për katër programe në Kroaci: për konkurrencën rajonale, transportin, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Në shkurt 2008, Komisioni dakordoi €76 milionë për Programin e IPA-s për Zhvillimin Rural për Kroacinë. Kjo do të kontribuon në modernizimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë, përfshirë industrinë e procesimit. Do të shenjëstrojë investimet, dhe në të njëjtën mënyrë do të stimulojë përmirësimet në fushat që lidhen me rregullat e BE-së – veçanërisht në sigurinë e ushqimit, veterinarinë, fitosanitarinë, mjedisin dhe standardet tjera.

Kjo jo vetëm që do ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, por do të ndihmojë poashtu që të pajisë vendin me ekspertizë që i nevojitet – dhe që BE do ta kërkojë – kur të bëhet Shtet Anëtarë.

Peshkimi mbetet i rëndësishëm për Kroacinë, dhe ka qenë një ndër pikat e diskutimit në negociatat për anëtarësim. BE po ndihmon sektorin edhe me porte të reja edhe me kapacitetet e vendeve për inspektim të peshkimit. €12 milionë janë rezervuar për këtë asistencë, si pjesë e përkushtimit të BE-së për të rritur mbështetjen për këtë sektor në përafrimin me legjislacionin e BE-së.




Programet e kuadrit të gjerë për asistencën e IPA-s në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë përfshijnë reformën e administratës publike, drejtësinë dhe policinë, përmirësimin e infrastrukturës lokale, ndihmën e vendit për të adoptuar dhe implementuar legjislativonin dhe standardet e BE-së, dhe përgatitjen për implementimin e politikave të BE-së për kohezion dhe zhvillim rural.

Nën programin kombëtar të vitit 2007, €9 milionë do të jepen për të asistuar reformat në polici në nivelin qendror dhe lokal. Projekti për përgatitjen që vlen €3 milionë, do të ndihmojë në implementimin më të shpejtë të projekteve dhe në

përgatitjen e programeve të ardhshme të IPA-s.

Në dhjetor 2007 Komisioni Evropian dakordoi €19 milionë në kuadër të Programit të IPA-s për Zhvillimin Rural që të ndihmojë modernizimin e sektorit të bujqësisë në mënyrë të qëndrueshme.

Po në këtë muaj, Komisioni miratoi programet në vlerë prej € 56.8 milionë për zhvillimin rajonal (përfshirë transportin dhe mjedisin) dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.



Projekti i parë i IPA-s i lansuar në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka qenë ofrimi i asistencës për zhvillimin e policisë – duke demonstruar rëndësinë që BE i jep reformave të policisë në vend. Ky projekt, me këshillim të vazhdueshëm për policinë në nivel qendror, rajonal dhe lokal, sikur edhe për Ministrinë e Brendshme, është faza e fundit e mbështetjes së gjatë për reformat në drejtësi dhe çështje të brendshme. Edhe një projekt i kohëve të fundit ka ofruar komunikim të ri për policinë përmes ofrimit të pajisjeve të reja për radio komunikim.

Asistenca e IPA-s për Turqinë përfshinë mbështetjen për institucionet – brenda gjyqësorit, shërbimeve të zbatimit të ligjit dhe seksioneve kryesore të administratës publike – që janë drejtpërdrejtë të lidhura me reformat politike dhe mbështetjen e mëtutjeshme në zhvillimin e shoqërisë civile. Kjo poashtu përfshinë edhe mbështetjen në miratimin dhe implementimin e ligjit të BE-së në përgatitjen e aftësisë së Turqisë që të marrë detyrime të anëtarësimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është promovimi i Dialogut të Shoqërisë Civile në mes të BE-së dhe Turqisë.

Asistenca e BE-së poashtu do të ndihmojë vendin të përgatitet për pjesëmarrje në politikën kohezive të BE-së dhe në instrumentet për zhvillimin rural. Në këtë kontekst, Komisioni ka miratuar programet shumë-vjeçare me asistencë në vlerë prej €682.7 milionë në periudhën 2007-2009 për konkurrencën rajonale, mjedisin, transportin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Turqi.

Komisioni poashtu ka miratuar Programin shumë-vjeçar të IPA-s për Zhvillimin Rural të Turqisë me asistencë që kap vlerën €159 milionë në mes të viteve 2007-2009, që i kontribuon modernizimit të sektorit të bujqësisë, dhe inkurajimit të përafritimit me rregullat e BE-së në sigurinë e ushqimit, veterinarisë, fitosanitarisë, mjedisit dhe standardeve

“Është qenësore që njerëzit në BE dhe Turqi të njohin njëri tjetrin më mirë. Ne duhet që edhe më tutje të mbështesim në mënyrë të sinqertë dialogun në mes të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, sindikatave, organizatave kulturore, universiteteve, think tank dhe OJQ-ve.”

Presidenti i Komisionit Evropian José Manuel Barroso, Kuvendi i Madh Kombëtar i Turqisë, Ankara, 10 prill 2008

Një projekt i financuar nga BE ka mbështetur përpjekjet e Turqisë për të eliminuar punën e fëmijëve deri më 2011. Ka ofruar ndihmë për përafërsisht 3000 fëmijë dhe familjet e tyre për arsimim, rehabilitim dhe shërbime mbështetëse. Më shumë se 2000 fëmijë janë regjistruar në shkolla dhe një pjesë e shpenzimeve të tyre për edukim janë mbuluar nga buxheti i këtij projekti.



Fushat kryesore të fokusit të asistencës së BE-së për Shqipërinë përfshijnë zhvillimin ekonomik dhe social sikur edhe stabilizimin demokratik. IPA do të sigurojë që projektet e ndërtimit të institucioneve do të vazhdojnë, për të rritur efikasitetin e organeve ekzekutive dhe legjislativ të Shqipërisë. Mbështetje do t'i jepet poashtu në ofrimin e qartësisë juridike në pronësinë private si dhe në përmirësimin e zbatimit të sundimit të ligjit.

Fondet e IPA-s do të promovojnë përfshirjen sociale dhe ekonomike të pakicave dhe grupeve të cënueshme, projekteve për anti-korrupsion dhe zhvillim

të shoqërisë civile për të kontribuar në stabilizimin demokratik. Shembuj tjerë të sektorëve të mbështetur janë transporti, mjedisi sikurse edhe zhvillimi rural dhe rajonal.

Gjithashtu, financimi i IPA-s do të forcojë bashkëpunimin ndër-kufitar të Shqipërisë me Greqinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin trans-nacional "Evropa Jug-Lindore" i cili promovon integrimin më të mirë përgjatë tërë rajonit.

Forcimi i kapaciteteve administrative dhe mbështetja e përpjekjeve vendore në ndërtimin e institucioneve demokratike janë disa prej objektivave parësore për IPA-n në Bosnje dhe Hercegovinë, për të ndihmuar që të bëhet shtet më demokratik, i qëndrueshëm dhe funksional. Mbështetja poashtu do të ofrohet për zhvillimin e demokracisë lokale dhe për zhvillimin e shoqërisë civile për të kontribuar, në mes tjerash, luftën kundër korrupsionit.

Prioritetet tjera të programit janë asistencë për gjyqësorin, të drejtat e njeriut, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e pakicave,

procesin e kthimit si dhe grupet e cënueshme. Poashtu do të ketë mbështetje financiare për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, përshtatjen e sistemit të edukimit me nevojat e tregut të punës, si dhe reformimin e sistemit të shëndetit publik.

IPA do të mbështesë bashkëpunimin ndër-kufitar me vendet fqinje: Kroacinë, Malin e Zi, dhe me Italinë përmes programit IPA Adriatik.



BE ka financuar ndërtesën e re të gjykatës në Vlorë, Shqipëri. Demokracia dhe sundimi i ligjit në vend do të konsolidohet edhe më tej përmes projektit 30-mujor të IPA-s në vlerë €4.5 milionëshe i lansuar në maj të 2008 për të ndihmuar zhvillimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm e modern.

BE poashtu financon reformat në arsim, si në përmirësimin e lidhjeve me tregun e punës, ashtu edhe në përmirësimin e kushteve në objektet arsimore. Shkolla fillore në Hadzici-Binjezevo ka qenë në gjendje të shkatërruar para financimit të BE-së për rehabilitimin e saj – përfshirë instalimin e sistemit të ngrohjes dhe renovimin e klasave deri në gjendje të duhur. Tani, 80 fëmijët të cilët ndjekin mësimin në këtë shkollë kanë kushte të përshtatshme për mësim.



Në Kosovë, asistenca e BE-së do të fokusohet në zhvillimin e një shoqërie stabile, moderne, demokratike dhe multi-etnike të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe interesave të të gjitha komuniteteve.

Fuqizimi i sundimit të ligjit është njëri nga prioritetet e programit të IPA-s për Kosovë, së bashku me përkrahjen për kthimin, ri-integrimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore. Prioritetet tjera janë ndërtimi i një mjedisi ekonomik për të gjitha komunitetet e Kosovës, infrastruktura rrugore, mbështetja e qeverisjes lokale, edukimi, energjia, siguria e ushqimit dhe shërbimet e veterinarisë dhe prokurimi publik.

Në 2008, IPA ka filluar të ofrojë bursa për ta ngritur kapacitetin profesional të shërbimeve publike të Kosovës përmes ofrimit të arsimit universitar në Shtetet Anëtare të BE-së.

Një djalosh mban në dorë broshurën 'Eja në Evropë' gjatë performancës rrugore të BE-së në Klinë më 18 maj 2008, e cila inkurajoi interesim në nivelin lokal për procesin e integrimit



IPA do të plotësojë €50 milionë të dhënë nga BE për rehabilitimin e infrastrukturës transportuese në Kosovë që nga 1999 – përfshirë urën e re në autoudhën Prishtinë-Shkup.

IPA do ta ndihmojë Malin e Zi në sfidat me vazhdimin e reformave në gjyqësi dhe administratë publike, dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Projektet do të mbështesin policinë në luftimin e terrorizmit, drogës, trafikimit me qenie njerëzore, dhe do të ndihmojë autoritetet për të siguruar asistencë adekuate për viktimat.

IPA poashtu do të financojë projekte në tregun e brendshëm, dogana, konkurrencë, mjedis, energji, bujqësi dhe veterinari dhe kontrollë fitosanitarike. Agjenda poashtu përfshinë forcimin e konkurrencës në ekonominë malazeze dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit. Projektet do të mëtojnë të konsolidojnë situatën makroekonomike, ristrukturimin e ndërmarrjeve, përmirësimin e

teknologjisë dhe arsimin dhe trajnimin profesional, dhe përmirësimin e infrastrukturës në transport, energji dhe mjedis.

Fushat kyçe të mjedisit përfshijnë vlerësimin e ndikimit në mjedis; ujin e ndotur, mbeturinat inerte dhe ndotjen e ajrit. Transporti do të përfitojë nga ndihma në zhvillimin e politikave, legjislacionit dhe kapacitetit institucional, e posaçërisht në aviacion.

Mali i Zi poashtu merr pjesë në bashkëpunimin ndër-kufitar në çështjet mjedisore dhe ato detare me Italinë, Slloveninë dhe Greqinë, sikurse edhe me Serbinë, Kroacinë, Bosnje Hercegovinën dhe Shqipërinë.

Sikur edhe dëshmon rasti i qytetit Perast, Mali i Zi është parajsë për turizëm, që është edhe njëra ndër shtyllat e ekonomisë. BE ka ndihmuar në krijimin e mjedisit ligjor për themelimin e partneriteteve private-publike në këtë sektor. Por IPA poashtu do të ndihmojë në përcaktimin e kompetencave institucionale për mbrojtjen e turizmit dhe mjedisit, dhe në reformimin e zyrës vendore për statistika në mënyrë që të gjurmohet më qartë ndikimi i industrive kryesore.



Projektet konkrete të IPA-s tani mund të fillojnë në Serbi pas nënshkrimit të marrëveshjes financiare me Komisionin Evropian mbi programin e IPA-s 2007 në prill 2008.

Asistenca e BE-së mëton të mbështesë Serbinë në implementimin e reformave të nevojshme në rrugën e saj drejt BE-së. Projektet në mes tjerash janë të fokusuara në ndihmë ndërtimit të institucioneve shtetërore dhe administratës publike, luftimit të korrupsionit, zhvillimit të balancuar rajonal, dhe inkurajimit të bashkëpunimit me Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë. Projektet e tjera përfshijnë mbështetjen e person-

ave të zhvendosur dhe refugjatëve si dhe themelimin e zyrës së Ombudspersonit. Projektet e IPA poashtu kanë për qëllim zvogëlimin e ndotjes dhe përmirësimin e sigurisë së trafikut në Danub.

Shuma e përgjithshme prej €165 milionë është alokuar për 37 projekte në 2007. Njëri nga këto, në vlerë prej €21 milionë, merret me zhvillimin rajonal socio-ekonomik.

Serbia poashtu do të merr pjesë në programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfshijnë Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

Zhvillimi i bujqësisë së Serbisë – dhe ngritja e kapacitetit të Ministrisë së bujqësisë – është njëri ndër prioritetet e BE-së për këtë vend. Ekspertët nga rajoni i Rioja së Spanjës janë duke ndihmuar kultivuesit e verës në Serbi për të përmirësuar cilësinë dhe konkurrencën e produkteve të tyre, dhe janë duke i ofruar ndihmën e tyre zyrtarëve në thjeshtësimin e rregullave për prodhuesit dhe konsumatorët në linjë me legjislacionin e BE-së.

Programi për shumë përfitues mbështetë aktivitetet që promovojnë bashkëpunimin rajonal në mes të vendeve candidate potenciale dhe vendeve candidate. Ky program fokusohet në interesat dhe nevojat e përbashkëta, me qëllim të përgjithshëm rritjen e kohezionit dhe përparimin e pozitës ekonomike rajonale. Programi i plotëson veprimet e ndërmarra në programet kombëtare të IPA-s.

Rreth €880 milionë janë alokuar përmes programit të IPA-s për shumë përfitues në mbështetje të përpjekjeve për anëtarësim në BE. Disa nga aktivitetet që do të mbështeten janë:

- ◇ intervenimet e përbashkëta me institucionet ndërkombëtare financiare për të përmbushur nevojat ekonomike dhe sociale;
- ◇ reformimi i institucioneve akademike dhe asistimi i programeve të shkëmbimit të studentëve dhe stafit akademik përmes programeve Tempus dhe Erasmus;

- ◇ forcimi i kapaciteteve administrative dhe ndihma në përafrimin e organeve kombëtare dhe legjislacionit në linjë me Acquis e BE-së;
- ◇ mbështetja për dialogun me shoqërinë civile dhe zhvillimin e saj;
- ◇ reformimi i administratës dhe gjyqësorit dhe luftimi kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- ◇ krijimi i një strategjie rajonale për zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Programi për shumë përfitues forcon përvorjet multilaterale të vendeve përfituese dhe inkurajon marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë që janë parakusht i anëtarësimit në BE. Poashtu promovon rritjen dhe stabilitetin përgjatë rajonit, prej të cilave përfitojnë poashtu të gjitha Shtetet Anëtare.

Asistenca e BE-së për krijimin e strategjisë rajonale për zvogëlimin e rrezikut të fatkeqësive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi do të ndihmojë luftimin e fatkeqësive siç janë zjarret, vërshimet dhe tërmetet, dhe ofron koordinim më të mirë për ballafaqimin me pasojat e fatkeqësive.



Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësisë jo vetëm që i jep BE-së më shumë ndikim nga investimet e saj duke u ofruar ndihmë vendeve në rrugën e tyre drejt anëtarësisë.

Nga aspekti administrativ, IPA i ofron BE-së një kornizë koherente për menaxhim dhe decentralizim gradual apo delegim të menaxhimit tek vendi përfitues. Poashtu ai lejon fleksibilitet në aplikimin e asistencës.

IPA ofron lidhje të fortë në mes të aspekteve të buxhetimit dhe politikave të zgjerimit. Gjithashtu ua bën të qartë vendeve përfituese se çfarë asistence mund të presin, në qoftë se i plotësojnë kërkesat e nevojshme. Në këtë mënyrë, IPA i fuqizon udhëzimet që i ofron BE për vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë për prioritetet që duhet të ndjekin.

Por mbi të gjitha, IPA ndihmon që këto vende, që nuk janë vetëm fqinjë të tyre, por edhe anëtarë potencial të ardhshëm për anëtarësim në BE, të zhvillojnë standartet dhe vlerat që i ndërton BE. Në këtë mënyrë, IPA është një investim real për të ardhmen- për vendet përfituese, dhe për vetë BE. IPA i sjellë fokus të ri asistencës së BE-së për zgjerim.

“BE vazhdon mbështetjen e reformave dhe zhvillimit të Evropës Juglindore përmes IPA-s. Mesatarisht, alokimi vjetor për Ballkanin Perëndimor në periudhën 2007–2011 do të jetë €800 milionë. Kjo është shuma më e madhe për kokë banori e ofruar deri tani nga Komisioni për ndonjë rajon të botës”.

Olli Rehn, Konferenca për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Evropën Juglindore, Bruksel, 17 prill 2008

DP i Zgjerimit ofron një gamë të gjerë të informacioneve mbi IPA-n, dhe mbi të gjitha aspektet e procesit të zgjerimit dhe të vendeve të përfshira si kandidatë dhe kandidatë potencial për anëtarësim në BE. Shih http://ec.europa.eu/enlargement/index_en.htm

Tekstet kryesore të IPA-s përfshijnë:

- ◇ Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1085/2006 e 17 korrik 2006 për themelimin e Instrumentit të Para-Anëtarësisë (IPA) [Gazeta Zyrtare L 210 të 31.7.2006].
- ◇ Vendimi 2007/766/EC i 14 nëntor 2007 për hartimin e listës së rajoneve dhe zonave të përshtatshme për financim nën Komponenten e Bashkëpunimit Ndër-Kufitar të Instrumentit të Para-Anëtarësisë për qëllim të bashkëpunimit ndër-kufitar në mes të Shteteve Anëtare dhe vendeve përfituese për periudhën 2007 deri 2013 [Gazeta Zyrtare L 310 të 28.11.2007].
- ◇ Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 718/2007 të 12 qershor 2007 për implementimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 1085/2006 për themelimin e një instrumenti për asistencë të para-anëtarësisë (IPA) [Gazeta Zyrtare L 170 të 29.6.2007]
- ◇ Komunikatë nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian – Instrumenti për asistencë para-anëtarësisë (IPA) – Korniza indikative financiare shumë-vjeçare për 2010-2012 [COM(2008) 705].

Komisioni Evropian - Drejtorati Gjeneral për Zgjerim
IPA Instrumenti për asistencë të para-anëtarësimit –Foku-
si i ri i Asistencës së BE-së për zgjerim
Luksemburg: Zyra e publikimeve zyrtare të Komuniteteve Evropiane
2009 – 20 fq – 14.8 x 21 cm

ISBN 978-92-79-11333-8

Si mund t'i gjeni publikimet e BE-së

Publikimet mund të blihen përmes:

- Librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>);

Publikimet falas mund të gjinden përmes:

- Librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>);
- Zyres përfaqësuese të Komisionit Evropian.

Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, Rr. Kosova 1, Fahu postar
331, Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 38 5131 200, Faks: +381 38 5131 305, Web:
www.delprn.ec.europa.eu, Email:ec-liaison-office-kosovo@ec.europa.eu